



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A1 Vonesa në realizimin e punëve të kontraktuara.
- A2 Tejkalim në realizimin e sasive të kontratës publike kornizë dhe mos përputhje me peshën e përcaktuar në dosje të tenderit.
- A3 Mos përmbushja e detyrimit ligjor për verifikim të 20% të pronave të paluajtshme të tatimpaguesve.
- B1 Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara, si dhe pagesa të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 312,908.00€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 238,110.00€, ndërsa 74,798.00€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës gjyqësore/përmbartimore dhe interesit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Klinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keq klasifikim e shpenzimeve, dobësi në menaxhimin e kontratave publike, vonesat në kryerjen e punëve, mos raportimi i menaxhereve të kontratave në sistemin e-prokurimit, si dhe mungesa e ndërmarrjes së veprimeve në për mbledhjen e borxheve, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese.

dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Po ashtu, për shkak të mos kryerjes së obligimeve me kohë, thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës për vitin 2024 në vlerë prej 312,908€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 238,110€, ndërsa 74,798€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës gjyqësore/përmbartimore dhe interesit.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe tri (3) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Vonesa në realizimin e punëve të kontraktuara

#### Gjetja

Rregullorja 001/2022 për prokurim publik neni 70.23 thekson se përgjegjësi e menaxherit të projektit është të menaxhoj obligimet dhe detyrat e AK-së të specifikuar në kontratë dhe të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë, bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Ne identifikuam mangësi në menaxhimin dhe ekzekutimin e kontratave si në vijim:

- Projekti “Ndërtimi i fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë” në vlerë 849,922€, kontrata ishte nënshkruar më 12.10.2023, dhe afati i ekzekutimit të punimeve ishte data 11.10.2024. Deri në kohën sa ne ishim në auditim (në fazën e ekzekutimit maj 2025), sipas menaxherit të kontratës ishin kryer 75% të pagesave. Kishte vonesa në kryerjen e punëve dhe Operatori ekonomik (OE) më 31 janar 2025 kishte kërkuar zgjatje të afatit me arsyetimin se ka pasur kushte të vështira atmosferike dhe probleme teknike gjatë montimit të një pompe e cila nuk kishte funksionuar, si dhe rivlerësimi i punëve shtesë, nga të gjitha palët e involvuara në projekt; dhe
- Projekti “Ndërtimi i nxehtësisë qendrore me pompa termike në SHFMU Motrat Qiriazit” në vlerë 64,975€, kontrata ishte nënshkruar më 07.05.2024, dhe afati i ekzekutimit të punimeve ishte 10.07.2024 (60 ditë kalendarike). Projekti kishte vonesë në ekzekutim dhe OE me shprehjen e datës 21.10.2024 kishte kërkuar vazhdim të afatit deri më datë 13.12.2024 me arsyetimin se OE nuk ka mundur të kryej liferimin e pajisjeve për shkak të vonesës së importit. Deri sa ishim në teren (maj 2025) pranimi teknik nuk ishte kryer ende me arsyetimin se duhet të sigurohet një trafo elektrike e re.

Vonesat në realizimin e punëve sipas menaxherëve të kontratave kanë qenë për shkak të kushteve atmosferike, mos zgjidhjes së problemeve pronësore, si dhe mos liferimit të pajisjeve me kohë. Por, është vërejtur se vonesat kanë ndodhur edhe si rezultat i mos planifikimeve reale, dhe planeve dinamike të mangëta për kryerjen e punimeve.

#### Ndikimi

Mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuar në kontratë tregon se planifikimet e afateve kohore, planet dinamike por edhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara duke ndikuar që punët të vonohen dhe mos realizohen siç ishin me kontratë. Si pasojë e mos realizimit me kohë të projekteve, qytetarët e komunës nuk i marrin shërbimet me kohë.

#### Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që para inicimit të procedurave të prokurimit së pari projektet të jenë të detajizuara dhe të ekzekutueshme, të përcaktohet volumi dhe afatet reale për përfundimin e punëve, si dhe paraprakisht të zgjidhen problemet pronësore në vendet ku duhet të kryhen projektet. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin

e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Tejkallim në realizimin e sasive të kontratave publike kornizë, në mos përputhje me peshën e përcaktuar në dosje të tenderit.**

##### **Gjetja**

Rregullorja nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 17.35, përcakton se "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë të secilës "kategori të shërbimeve" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të autoritetit kontraktues".

Në kontratën publike kornizë "Ofrimi i shërbimeve shëndetësor, kujdesi paliativ" në vlerë të parashikuar prej 550,000€, dhe kohëzgjatje të kontratës 36 muaj, e cila deri me datën 31.12.2024 ishte realizuar në vlerën prej 439,151€ apo 80%. Kishte tejkallime të sasive të faturuara dhe paguara tek pozicionet si në vijim:

- Pozicioni 4 "shërbimet sociale në teren" sipas dosjes së tenderit ishte dhënë pesha prej 5% apo 27,500€ për pozicion në bazë të rëndësisë. Nga analiza e realizimit për këtë pozicion kemi vërejtur se deri me 31.12.2024 ishte fatuarur dhe paguar vlera 212,075€ apo 48% e totalit të shpenzimeve për kontratën; dhe
- Pozicioni 5 "shërbimet sociale të kujdesit parësor shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ", sipas dosjes së tenderit ishte dhënë pesha prej 5% apo 27,500€ për pozicion në bazë të rëndësisë. Ky pozicion deri me 31.12.2024 ishte fatuarur dhe paguar gjithsej 210,625 € apo 48% e totalit të shpenzimeve për kontratën.

Vlen të theksohet se deri më 31.12.2024 në këto dy pozicione, janë shpenzuar gjithsej 422,700€ të cilat përbëjnë 76.85% të shpenzimit të vlerës së kontratës sipas dosjes së tenderit. Kjo tregon për një mospërputhje të madhe ndërmjet planifikimit dhe realizimit të kontratës.

Këto tejkallime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave dhe përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit, por edhe të menaxhimit jo të duhur të kontratës.

##### **Ndikimi**

Tejkallimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Po ashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore.

##### **Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas

peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit. Po ashtu duhet të siguroj që të mos tejkalohen sasi të e parashikuara me kontratë.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A3 - Mos përmbushja e detyrimit ligjor për verifikim të 20% të pronave të paluajtshme të tatimpaguesve.**

##### **Gjetja**

Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 15 pika 2, përcaktohet se "Komuna çdo vit inspekton të paktën njëzet për qind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese mund të angazhojë edhe inspektorë privat."

Komuna në vitin 2024 për tatimin në pronë të objekteve në sistemin Protax kishte të regjistruar 15,299 objekte. Ne kemi vërejtur se komuna nuk kishte arritur të bënte inspektimin (verifikimin) e 20% pronave të paluajtshme siç kërkohet nga ligji në fuqi, por kishte verifikuar vetëm 1,516 pronave të paluajtshme apo afër 10%.

Mos inspektimi i pronave, rezulton me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

##### **Ndikimi**

Moskryerja e inspektimit të pronave të paluajtshme mund të rezultojë në informacion jo të plotë për gjendjen aktuale të pronave, të hyra potencialisht më të ulëta të mbledhura në dobi të komunës, dhe gjithashtu mund të rezultojë në një ngarkesë tatimore joadekuate.

##### **Rekomandimi A3**

Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara dhe shpenzimet gjyqësore/përmbarrimore.**

##### **Gjetja**

Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Po ashtu neni 40.3 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit parash "Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrimit të formës së prerë, Ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrimit nga ndarjet buxhetore në dispozicion; me kusht që nëse vendimi i plotfuqishëm është nxjerrë kundër një komune, vetëm përvetësimet e komunës mund të shfrytëzohen për përmbarrimin e këtij vendimi"

Në tri (3) raste të detyrimeve (faturave) të pa paguara në vlerë prej 19,546€ obligimet nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në dy raste ishin nga 90 ditë, ndërsa një (1) rast vonesa ishte afër 5 muaj.

Po ashtu, për shkak të mos kryerjes së obligimeve me kohë, thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës për vitin 2024 në vlerë prej 312,908€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 238,110€, ndërsa 74,798€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës gjyqësore/përmbartimore dhe interesit.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

**Ndikimi**

Vonesat në kryerjen e obligimeve kanë shkaktuar kosto shtesë, përveç vlerës së faturës komuna kishte paguar kosto shtesë përfshirë kamatën dhe shpenzimet tjera procedurale gjyqësore/përmbartimore.

**Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Klinës në vitin 2024 ishin gjithsej 1,289,661€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjohat e gjykatave dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 478,599€.

#### Çështja C1 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve te tatimi në pronë

<b>Gjetja</b>	<p>Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e paluajtshme, neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.</p> <p>Nga auditimi i të dhënave të tatimit në pronë të viteve paraprake, ishin identifikuar 1,846 tatimpagues të objekteve, të cilëve në data bazë ju mungon numri personal, që në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë potencialisht përfitues të disa hershem nga zbritja e lejuar ligjore. Nga ky numër në vitin 2024 komuna kishte arritur që 311 tatimpagues t'i identifikonte dhe regjistronte me numër personal.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e kontrolleve jo të duhura dhe monitorimit të sektorit në pronë për të bërë verifikimin e të gjithë tatimpaguesve të objekteve me numër personal.</p>
<b>Ndikimi</b>	Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat personal të tatimpaguesve mund të ndikoj në përfitim të paligjshëm të disahershëm të tatimpagueseve, të zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor.
<b>Rekomandimi C1</b>	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,987,997€, derisa janë shpenzuar 4,605,207€ apo rreth 92% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e objekteve, rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

### Çështja B2 - Klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

<b>Gjetja</b>	<p>Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t’i aplikojnë.</p> <p>Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 57,599€. Nga kjo vlerë, Thesari kishte paguar me urdhër përmbarimor sipas vendimit të gjykatës për paga jubilarë, nga kategoria e investimeve kapitale 55,506€, dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 1,993€.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për ti realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore përmbarimore.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.</p>
<b>Rekomandimi B2</b>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.</p>

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja C2 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

<b>Gjetja</b>	<p>Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”</p> <p>Menaxherët e kontratave kanë filluar mbajtjen dhe arkivimin dokumenteve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së ekzekutimit të kontratave. Megjithatë, nga 17 mostra të testuara kemi vërejtur se në 10 raste regjistrat e menaxhimit të kontratave nuk janë zhvilluar përmes platformës së e-prokurimi.</p> <p>Kjo kishte ndodhe si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes e-prokurimit.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik</p>

mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna, në PFV-të e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,384,665€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 2,058,227€, taksat për ushtrim të veprimtarisë biznesore 1,097,138€, si dhe nga qiraja komunale 229,300€.

#### Çështja C3 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27. Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2024 ishin gjithsejtë 3,384,665€, Në krahasim me vitin paraprak ato ishin ulur për 356,024€, për shkak se menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime duke dërguar kërkesë të inicimit të procedurës përmbarimore, ndaj disa debitorëve për përmbushjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë. Megjithatë vlera e këtyre borxheve është ende e lartë dhe komuna duhet të vazhdojë të ndërmarrë veprime për arkëtimin e borxheve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së borxheve.

**Ndikimi** Moszbatimi i mekanizmave të vendosur me ligj dhe rregullore ndikon në rritjen e vazhdueshme të kërkesave llogarive të arkëtueshme, gjë që rezulton në më pak fonde për arritjen e qëllimeve dhe nxit debitorët e tjerë që të mos përmbushin detyrimet e tyre.

**Rekomandimi C3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>14,648,717</b>	<b>15,866,597</b>	<b>15,408,878</b>	<b>14,691,283</b>	<b>11,547,857</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	13,212,457	13,368,029	13,261,524	12,048,247	9,910,436
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	97,023
Të bartura nga viti i kaluar	0	942,122	834,666	1,227,234	850,471
Të hyrat vetanake	1,436,260	1,436,260	1,249,988	951,375	663,127
Donacionet vendore	0	117,611	62,699	37,023	21,362
Donacionet e jashtme	0	2,575	0	427,403	5,438

Buxheti final i Komunës së Klinës është më i lartë se buxheti fillestar për 1,217,880€. Kjo rritje e buxhetit është i rezultat i vendimit të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 155,572€, përfshirjes së të hyrave të bartura prej 942,122€ dhe donacionet në vlerë 120,186€.

Në vitin 2024, Komuna ka shpenzuar 15,408,878€ ose rreth 97% të buxhetit final, me një rritje prej 3% në raport me vitin e kaluar. Komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore ju kanë ekzekutuar 312,908€ nga kategori të ndryshme ekonomike.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>14,648,717</b>	<b>15,866,597</b>	<b>15,408,878</b>	<b>14,691,283</b>	<b>11,547,857</b>
Pagat dhe mëditjet	7,936,857	8,092,429	8,092,429	7,406,952	6,441,464
Mallrat dhe shërbimet	1,710,000	1,807,649	1,761,497	1,716,951	1,340,624
Komunalitë	250,000	270,001	269,888	235,176	166,972
Subvencionet dhe transferet	600,000	708,522	679,857	420,963	401,429
Investimet Kapitale	4,151,860	4,987,997	4,605,207	4,911,241	3,197,368

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 155,572€. Kjo rritje vjen nga granti qeveritar me Vendim të Qeverisë së Kosovës, për mbulimin e minusit në pagave që janë paguar përmes vendime gjyqësore përmbarimore për kontratat kolektive.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 97,649€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.
- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 20,001€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 108,522€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 për 24,149€ dhe nga granti i përcaktuar i donatorëve për 84,373€..
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 836,137€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara 800,323€, si dhe rritje nga donacionet për 35,814€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e buxhetuara nga Komuna e Klinës për vitin 2024 ishin 1,436,260€, ndërsa ishin realizuar gjithsej 1,289,661€ apo afër 90% e planifikimit buxhetor. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 478,599€.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,436,260</b>	<b>1,436,260</b>	<b>1,289,661</b>	<b>1,385,801</b>	<b>1,208,535</b>
Të hyrat tatimore	654,421	654,421	550,999	621,791	453,281
Të hyrat jo tatimore	781,839	781,839	737,789	764,010	755,254
Të hyrat tjera	0	0	873		

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Komunës së Klinës ka rezultuar në tetë (8) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tri (3) rekomandime janë zbatuar; tri (3) ishin në proces dhe në dy (2) nuk ka filluar zbatimin ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.	Rekomandimi është zbatuar pjesërisht nga se ende vazhdojnë mangësitë për numrat personal të tatimpaguesve në sistemin protax.	Pjesërisht i zbatuar

2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të shtojë kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.	Nga testimet e mostrave kemi vërejtur se dokumentet që është dashur të ngarkohen në sistemin e-prokurimi janë ngarkuar, prandaj konkludojmë se ky rekomandim është zbatuar.	I zbatuar
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i vlerësimit do ta bëjë vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve në pajtim me kriteret e përcaktuara me Thirrje Publike.	Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se gjatë vlerësimit të aplikacioneve për subvencione komisionet e vlerësimit bëjnë vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve në pajtim me kriteret e përcaktuara me Thirrje Publike. Prandaj konkludojmë se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Edhe gjatë vitit 2024, ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve, prandaj kemi konkluduar se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.	Edhe pse entiteti kishte ndërmarrë veprime për menaxhimin e kontratave përmes sistemit të e-prokurimit ende ka raste që kontratat nuk menaxhohen përmes platformës elektronike e-prokurimi.	Pjesërisht i zbatuar

6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar raste të njëjta sikurse vitin e kaluar, prandaj konkludojmë se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.	Gjendja e llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak është zvogëluar, megjithatë nuk janë marrë masa të mjaftueshme në mbledhjen e tyre nga departamentet përkatëse.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Xhevat Seferi, Udhëheqës i ekipit








Valon Halimi, Anëtar i ekipit



Xhevat Hasolli, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

 <p>REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVO</p>	<p>www.komuna-kline.org</p>	<p>KOMUNA E KLINËS MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA</p> 
<h3>LETËR E KONFIRMIMIT</h3>		
<p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve.</p>		
<p>Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit</p>		
<p>Të nderuar,</p>		
<p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p>		
<ul style="list-style-type: none"><li>• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Klinës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");</li><li>• pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe</li><li>• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.</li></ul>		
<p>Z. Zenun Elezaj</p> 		
<p>Data: 29 maj 2025, Klina</p> 		

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.